

## Lef Nosi s'e kishte të dashur Margaret Hasluck

Robert Elsie

TIRANË - Ndërsa po bisedonim me studiuesin dhe albanologun Robert Elsie për zbulimin e “Koleksionit” të rrallë të Margaret Hasluck (1885-1948), me rrëfenja e folklor shqiptar, kujtuam mikun e saj shqiptar, Lef Nosin, për figurën e të cilit u ndez një debat publik nga Ben Blushi. Politikani dhe shkrimtari Ben Blushi është nipi i shkrimtarit e studiuesit shqiptar Dhimitër Shuteriqi. Blushi, një javë më parë u shpreh në një emision mediatik se “shpresoj që bustin e Lef Nosit (e kishte fjalën për shtatoren...) ta tërheqin zvarrë qytetarët e Elbasanit”, sepse sipas tij, Lef Nosi ishte bashkëpunëtor me fashistët. Elsie që e ka zbuluar Lef Nosin me vlerat e një gjeniu nga librat e etnologes skoceze, Margaret Hasluck, befasohet nga qëndrimi i Ben Blushit.

“Ç’është ky qëndrim,” - thotë ai. – “Po ta shohësh nga distanca e kohës së sotme, kush e dëmtoi më shumë shkencën, një bashkëpunëtor i fashistëve apo një bashkëpunëtor i komunistëve?”

Albanologu i shquar Robert Elsie e ka kuptuar se bashkëpunimi me politikanët dhe demagogët komunistë që censuruan autorët dhe historinë i ka sjellë më shumë dëm kombit shqiptar. Që kur ka kuptuar këtë, vet ai Elsie gjurmon historinë dhe kulturën shqiptare.

Ka një Shqipëri tjetër të panjohur, që është “në dorën” e albanologut të njohur kanadez. Mbi 25 vjet i lidhur ngushtë me tokën, me njerëzit e kulturën shqiptare, pas kërkimeve dhe studimeve të paepura në malet e Shqipërisë, ai ka gjurmuar vepra të rralla të autorëve të huaj, të atyre që shkruan dhe dokumentuan kulturën dhe historinë shqiptare. Sipas tij, këta autorë po i zbulojnë botës një Shqipëri të panjohur. “Zbulimi i Shqipërisë” titullohet vepra e Johann Georg von Hahn në gjuhën angleze, ku shënonte udhëtimet dhe studimet për antropologjinë e Ballkanit në shekullin e 19-të.

Librat e Michael Schmidt-Neke, të Johanna Jutta Neumann apo “Koleksioni” i rrallë i Margaret Hasluck, mikes dhe bashkëpunëtores së ngushtë të Lef Nosit në fushën e kulturës popullore, janë disa nga dhjetërat e studimeve voluminoze ende të panjohura të të huajve për Shqipërinë dhe shqiptarët. Vetë Robert Elsie ka botuar 97 libra etnografikë, studimor e historik për Shqipërinë. Këtë vit ka botuar librin e 98-të në anglisht. Para një ore të intervistës tonë i kishte ardhur kopertina e librit të ri nga Londra. Ishte libri i dosjeve të Blendi Fevziut për Enver Hoxhën...

Profesor Elsie, ju, duke përmendur “Koleksionin” e Margaret Hasluck na sillni në kujtesë edhe Lef Nosin. Si e ke njohur?

- Lef Nosin unë e kam njohur më mirë kur jam marrë me “Koleksionin” e Hasluck dhe tregimet popullore shqiptare, që është një ndër veprat e shumta të saj për Shqipërinë. Te Koleksioni gjenden mbi 115 rrëfime folklorike të mbledhura dhe përkthyer në anglisht nga antropologia skoceze Margaret Hasluck në fund të 1920-s dhe në 1930-n. Ky është një nga koleksionet më të mëdha të tregimeve popullore shqiptare që janë përkthyer ndonjëherë në gjuhën angleze. Është e njohur tashmë që Lef Nosin regjimi komunist e ekzekutoi me pushkatim në vite ‘40. Margaret Hasluck, etnografia dhe sociologe e njohur ishte mikja e Lef Nosit. Ajo qëndroi në Elbasan në vitet ‘20, ku ka blerë edhe shtëpi atje. Iku kur Shqipëria u pushtua nga fashistët italianë. Ajo donte ta shpëtonte

Lef Nosin nga pushkatimi dhe u shkroi qeveritarëve komunistë dhe Enver Hoxhës për vlerat e tij, por nuk mundi ta shpëtonte.

Ka zëra që thonë se ishte më shumë se mike... A kishte qenë Margaret Hasluck edhe e dashura e Lef Nosit?

- Ishte mike, nuk e di për të dashur, por di që ishin shumë miq. Ata bashkëpunonin për shkrimet shkencore dhe ajo e vlerësonte. Lef Nosi ishte i martuar atëherë në Elbasan dhe Elbasani ishte një qytet i vogël dhe ndoshta kishte thashetheme të tilla. Unë di që ajo kishte një bibliotekë të rrallë me librat e saj në Elbasan. Kur iku ajo nga Italia, e mori pjesë pastaj në luftërat në Kajro, në Stamboll nuk u kthye më, edhe pse kishte një shtëpi në Elbasan. Është akoma shtëpia atje.

Ju keni shkruar kur u dixhitalizua alfabeti i Elbasanit, se Lef Nosi ishte një koleksionist i madh dhe shpreheni se “Alfabeti i Elbasanit ka qenë ruajtur nga Lef Nosi dhe nuk dihet sesi ra në dorë të Dhimitër Shuteriqit”. Gjendet ky artefakt në arkivin e shtetit shqiptar.

- Është në arkiva, por unë nuk e di historinë nëse përfundoi më vonë në arkiva apo ka qenë më parë në bibliotekën e Dhimitër Shuteriqit. Shqipëria para se të sekuestroheshin nga komunistët nuk kishte vetëm arkivin e Lef Nosit, që janë sekuestruar, por kanë qenë biblioteka të Mit'hat Frashërit (Lumo Skëndos), e Lef Nosit dhe e Eqerem Bej Vlorës. Dihet që Eqerem Vlora kishte një arkë shumë të madhe me libra, që nuk e mori dot të Itali. Kur iku ai, arkiva mbeti në Shqipëri. S'e di mirë si ra në duart e Shuteriqit. Po edhe nëse e mori Shuteriqi i ka shfrytëzuar, i ka botuar. Ndryshe do ishte e panjohur kjo vepër e madhe.

Por emri i Lef Nosit nuk përmendej?!

- Po, por më mirë në dorë të Dhimitër Shuteriqit sesa të binin në dorë të Koçi Xoxes. Përmendja e emrave të autorëve të ndaluar ishte tabu deri në vitet '90. Vetë Shuteriqi nuk ma zuri në gojë Lef Nosin. Unë atëherë nuk e dija lidhjen që ta pyesja.

Ju e njihni Martin Camaj apo jo.

- E kam lexuar. E pëlqej si autor, e çmoj stilin. Për mua është autor me rëndësi në letërsinë shqipe... Por, Martin Camaj, kur erdha në fillim më thanë se është shumë problem, mos e përmend emrin e tij. Dhe nuk më kanë lejuar ta përmend emrin e Martin Camaj ndër autorët shqiptarë, duke më thënë se është një fakt objektiv, që nuk ekziston në Shqipëri mes autorëve.

Dhe për Lef Nosin ka pasur më shumë arsye të mos përmendej se regjimi e ndëshkonte si kolaboracionist. Po a është normale që ta gjykojnë edhe sot disa intelektualë si Ben Blushi si të tillë? Çfarë vendi mendon se zë Lef Nosi në letrat shqipe?

- Unë do t'i përgjigjesha atyre që vazhdojnë ta ndëshkojnë se çfarë e ndryshon një studiues, shkrimtar apo historian që iu shërbeu komunistëve nga ai që u shërben fashistëve. Parë në dritën e sotme, historiani dhe shkencëtari që u shërbeu komunistëve ka qenë më keq se ai që u shërbeu fashistëve. S'e kuptoj pse Ben Blushi e gjykon Lef Nosin. Studiues i madh ishte Lef Nosi, studiues i madh është dhe Shuteriqi. Por shpesh nipërit e vet u nxjerrin sytë gjyshërve të tyre.

Dhe po doni të dini, edhe Lef Nosit ia ka nxjerrë sytë nipi i tij Frederik Nosi, që shërbeu si gjykatës në regjimin e Hoxhës, ndërsa Nosi u pushkatua. Kush mund të më thotë sot që ka kaluar shumë kohë se kush ishte më keq, ai që u shërbeu komunistëve, e që la jashtë studimeve pjesë nga historia kombëtare, apo nga letërsia kombëtare, ai që për t'u shërbyer komunistëve e mohoi në disa raste kulturën kombëtare, apo ai që u shërbente ndoshta fashistëve si bashkëpunëtor dhe të paktën ishte i lirë të studionte dhe mblidhte kulturën kombëtare. Lef Nosi e ka mbledhur, e ka studiuar dhe ka punuar e sakrifikuar për kulturën kombëtare. Ishte një intelektual i madh, një gjeni i letrave shqipe. Kjo është tragjedia e mohimit të vlerave në Shqipëri. Unë si studiues them se të dy janë intelektualë me vlera, me të bardhat dhe të zezat e tyre.

Njerëzit nuk duhet të kenë frikë nga figurat historike. Ka pasur që ishin aktivë në kohën e fashizmit, ka pasur aktivë në shërbim në kohën e komunizmit dhe në të dy anët kanë bërë kompromise. Nuk duhet dënuar një studiues shqiptar që ishte në pushtet në '43-shin dhe mund të ishte një adhurues i Hitlerit. Duhet gjykuar njësoj vlera e tij, se ishin njerëz, me të mirat dhe të këqijat e tyre. Duhet parë se çfarë veprash kanë sjellë.

Sapo keni hedhur në internet edhe të rejat nga libri i Von Hahn-it.

- Von Hahn ishte figurë e madhe në etnologjinë shqiptare. Ishte babai i etnologjisë, i pari austriak që u interesua për kulturën shqiptare në përgjithësi. Ka një fjalor të shqipes dhe u interesua edhe për përrallat shqiptare. E kam botuar këtë në librin "Zbulimi i Shqipërisë", sepse ishte i pari që e zbuloi atë në botën e jashtme. Mua më intrigon mënyra e saktë sesi të huajt e kanë studiuar Shqipërinë. Disa e admirojnë dhe e kanë kuptuar rëndësinë e kulturës së saj, por ka dhe disa që tmerrohen sesi mund të jetohej në ato male të ashpra shqiptare. Megjithatë ka shumë autorë, figura të mëdha që shkruajnë për Shqipërinë.

Disa janë autorë të njohur, disa nuk janë dëgjuar shumë në Shqipëri. Një nga figurat më të fundit që kam zbuluar është Shtajnmec (Steinmetz), një austriak që dinte shqip dhe për të dihet shumë pak. Udhëtonte vetë maleve në Nikaj e të tjera vende në veri të Shqipërisë, ku ka udhëtuar me këmbë nga Shkodra në Kosovë dhe në Mirditë.

Edhe një pyetje të fundit. Këto kohë është përfolur se ka humbur fjalori etimologjik i Nobert Joklit, kur ishte në kampet naziste. Si është e vërteta.

- Fjalori mitologjik i Joklit nuk ka humbur. E thonë shpesh dhe kanë bërë lajm sikur të jetë një mister i madh. Unë e kam parë fjalorin etimologjik të Joklit, nuk ka humbur, por është i shkruar me një stenografi të ndryshme, të rrallë. Vjen me format të gjatë, ku asnjë njeri nuk e lexon dot. Por ai është aty dhe duhet transkriptuar dhe zberthyer sistemi i kësaj stenografie. Por studiuesit mund ta shohin e ta studiojnë atë.

[Intervistuar nga Dhurata Hamzai dhe botuar në gazetën *Shqiptarja*, Tiranë, 12 nëntor 2015. <http://shqiptarja.com/kulture/2730/intervista--robert-elsielef-nosi-se--kishte-t--dashur-margaret-hasluck-326468.html>]